



IPA Energy + Water Consulting




Mundësia dhe Gatishmëria për të paguar – studim i shkurtër

Raport Final

Referenca e Dokumentit:IPA/03/DEL

Mars 2007



Support for the Water & Waste Regulatory Office, Kosovo

An EU-funded project managed by the European Agency for Reconstruction



IPA Energy + Water Consulting



IPA Energy + Water Consulting

41 Manor Place
Edinburgh
EH3 7EB
Scotland

Tel: +44 (0) 131 240 0840
Fax: +44 (0) 131 220 6440
E: contact@ipaenergy.co.uk
www.ipaenergy.co.uk

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
Gjetjet	1
Rekomandimet	2
1 HYRJE	3
2 BURIMET E TË DHËNAVE	4
3 ANALIZA E TË HYRAVE	5
3.1 Pjesa e përgjithshme	Error! Bookmark not defined.
3.2 Të hyrat mesatare të amvisërisë	5
3.3 Shpërndarja e të hyrave sipas amvisërisë	6
3.4 Shpërndarja e të hyrave sipas regjionit	6
3.5 Definicioni i të varfërit	Error! Bookmark not defined.
4 KËRKESA PËR UJË NGA AMVISËRITË DHE ANALIZA E MUNDËSISË	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
4.1 Kërkesa mesatare	9
4.2 Harmonizimi i të hyrave të kërkesës së ujit	Error! Bookmark not defined.
4.3 Harmonizimi i çmimit të kërkesës	Error! Bookmark not defined.
4.4 Çmimi i shërbimit që i ofrohet konsumatorëve	Error! Bookmark not defined.
4.5 Mundësia	11
4.6 Gatishmëria për të paguar	12
4.7 Mekanizmat e përkrahjes	Error! Bookmark not defined.
5 GRUMBULLIMI I MBETURINAVE NË AMVISËRI / ANALIZA E MUNDËSISË E DEPONIMIT	8
5.1 Çmimi i shërbimit që ofrohet konsumatorëve	Error! Bookmark not defined.
5.2 Mundësia	Error! Bookmark not defined.
5.3 Gatishmëria për të paguar	Error! Bookmark not defined.
5.4 Mekanizmat e përkrahjes	Error! Bookmark not defined.
6	8

AKRONIMET

EUR	Euro (valutë)
BPV	Bruto Produkti Vendor
BPK	Bruto Produkti Kombëtar
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KLMC	Kompania Menaxhuese e Deponive në Kosovë
MeF	Ministria e Financave
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Kosovë
NP	Ndërmarrjet Publike
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

ZRRUM Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina

Historia e Dokumentit dhe Gjendja

Versioni	Data	Shqyrtuar nga	Aprovuar nga	Hollësitë e Rishikimit
01 draft	06/03/07	GC	GC	minimale

Shpërndarja e kopjeve:

Rev Number	Sasia	Formati	Lëshuar nga	Lëshuar
01	1	Elektronik Elektronik	GC GC	ZRRUM (Afrim Lajci) AER (Alan Brown)

Versioni i Dokumentit:	Final
Numri i Projektit:	2045
I shtypur	17/03/2007
Ruajtja përfundimtare:	17/03/2007
Emri i dosjes:	Affordability Report_FINAL_070306
Autori:	Keith Burwell
Menaxheri i Projektit:	Graham Cleverly
Emrat e Organizatave:	IPA Energy + Water Consulting, MVV Energie, Edinburgh Economics
Emri i Projektit:	Përkrahja Institucionale ndaj ZRRUM-it
Emri i Dokumentit:	Raporti Final mbi Mundësinë dhe Gatishmërinë për të Paguar

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjetjet

Të dhënat në dispozicion për bërjen e një analize të mundësisë dhe gatishmërisë për të paguar janë të pakta, por megjithatë ka qenë e mundur të arrihen disa vlerësime si dhe konkluzione preliminare si vijon:

- 1 Të hyrat mesatare të amvisërisë duket që janë pak më të larta (EURO 376.00 në muaj) se sa që është raportuar në raportet e mëparshme kryesisht për shkak të inflacionit dhe efektit të shtimit për kokë banori.
- 2 Shpërndarja e të hyrave në Kosovë është relativisht uniforme me koeficientin “Gini” prej 0.29 (i ulët në krahasim me ekonomitë tjera në regjion). Të hyrat mesatare të 10 % më të varfërve është vlerësuar të jenë në lartësi 20 % të të hyrave mesatare të amvisërisë, ndërsaq të hyrat e 10 % të varfërve tjerë është vlerësuar të jetë në lartësi 40% të të hyrave mesatare të amvisërisë.
- 3 Shpërndarja e të hyrave sipas regjioneve është vështirë të përcaktohet por duke u bazuar në pagat mesatare, ajo duket të jetë relativisht të njëtrajtshme.
- 4 Vlerësohet se të varfërit përfshijnë 20 % të më të varfërve të popullatës, ku popullata e varfërve (nën nivelin e varfërisë) vlerësohen të jenë 10 % të më të varfërve të popullatës dhe korrespondojnë ngushtë me nivelin e varfërisë së konkluduar nga qeveria duke u bazuar në numrin e familjeve që marrin ndihmë sociale (8.4 %).
- 5 Konsumi mesatar i ujit për banorë është vlerësuar të jetë 80 litra për banor në ditë por për të varfërit është vlerësuar të jetë 50 litra bazuar në kërkesat për nevojat bazike.
- 6 Është vlerësuar se ndërmjet 6% dhe 10 % të amvisërive mund të kenë vështirësi për të paguar faturat e tyre të ujit.
- 7 Nëse përkrahja financiare për furnizim me ujë iu është ofruar 20% të më të varfërve të popullatës, atëherë ka mundësi që çmimet të rriten ndoshta deri në 100% ose më shumë. Qeveria është ajo që duhet të vendos nivelin e përkrahjes si politikë kombëtare e jo Rregullatori, të vendosë madje as të rekomandojë.
- 8 Rezistenca për të paguar faturat e ujit e tejkalon nivelin e pritur si pasojë e pamundësisë që sipas të gjitha gjasave i atribuohet: nivelit të dobët të shërbimeve, mundësi pagese, fuqive të kufizuara zbatuese, dobësive institucionale dhe ndikimeve politike.
- 9 Për të siguruar përkrahjen financiare për shërbimet e furnizimit me ujë të 10 % të popullatës së varfër do të kushtoj për afërsisht 1.2 milion EURO në vit, për afërsisht 1/4 e shumës së siguruar për ndihmuar të varfërve me faturat e energjisë elektrike. Nëse kjo përkrahje i ofrohet të varfërve, 20 % të popullatës atëherë shpenzimet do të jenë për afërsisht të shumës 2.5 milion EURO.
- 10 Tarifat aktuale për shërbimet e mbeturinave mund t’i përmbushin caqet e mbulimit të plotë të kostove nëse inkasimi do të ishte 100 %. Me shkallën aktuale të inkasimit (për afërsisht 50 %), tarifat e mbeturinave duhet të jenë më shumë se të dyfishuara për ta përmbushur kriterin e mbulimit të shpenzimeve.
- 11 Çmimet aktuale për mbeturina janë pak më të larta se sa pragu I mundësisë së cituar nga nga EPTISA ku niveli i mundësisë është 1% të të hyrave mesatare të amvisërisë por për të varfërit 10 % të amvisërive konsiderohet të jetë sa 5 % të të hyrave të amvisërisë për shkak të strukturës së njëjtë të çmimeve fikse të tarifave të mbeturinave.

- 12 Gatishmëria për të paguar shërbimet e mbeturinave është e ulët dhe barriera kryesore është mungesa e mekanizmave efektiv të zbatimit të pagesave, megjithëse edhe faktorët tjerë si sistemi i papërshtatshëm për pagesa, komunikimi i dobët dhe dobësia institucionale mund të jenë shkaktar i këtij problemi.

Rekomandimet

Në bazë të konkludimeve dhe analizave të bëra janë rekomanduar veprimet që vijojnë:

- 1 Duhet të kërkohet nga qeveria që të ekzaminojë mundësitë e ofrimit të përrkohjes financiare për amvisëri të varfëra që t'i plotësojnë obligimet e tyre por përkrahja e tillë duhet të jetë e balancuar me rritjet e çmimit duke filluar me nivelin e mundësisë të amvisërive të mbetura. Analiza paraprake sugjeron që me dhënien e përkrahjes financiare të varfërve 10 % të popullatës atëherë tarifat rriten për mbi 40% ose më shumë mund të tolerohet për 90 % e mbetur. Nëse përkrahja financiare është ofruar 20% të varfërve, rritja potenciale e tarifave mund të jetë për 100 % ose më shumë. Qeveria mund të udhëzoj ZRRUM-in që të ndërmarrë analizë më të hollësishme të shpenzimeve dhe fitimeve lidhur me strategjinë mbi të cilën mund të ndërtohet një politikë më e qartë. Procedurat administrative për ofrimin e përkrahjes sociale të varfërve duhet të zhvillohen nga qeveria dhe ndërmarrjet. Sidoqoftë precedenti është arritur me Marrëveshjen e mëparshme në mes KEK-ut dhe AKM-së për pagesat sipas kategorive të Subvencioneve dhe Transferit me shumë prej 10,076,000 që do të nevojiten për raste sociale gjatë vitit 2007.
- 2 ZRRUM-i së bashku me ndërmarrjet të cilat ofrojnë shërbime të ujit dhe mbeturinave duhet të ndërmarrin një kampanjë intensive për të inkurajuar amvisëritë që t'i përmbushin obligimet e tyre që e kanë detyrë qytetare dhe të mos llogarisin në mekanizmat zbatues pasi që ata janë treguar relativisht të paefektshëm.
- 3 Analiza mbështet ristrukturimin radikal të sektorit të ujit përmes mundësisë sociale me anë të transferimit të përgjegjësive me qëllim të ofrimit të shërbimeve strukturave komunale dhe që shërbimet të financohen përmes sistemit të tatimit në pronë. Kjo konsiderohet të jetë më e drejtë se sa sistemi aktual në amvisëritë dhe mund të vie deri te përmirësimet e rëndësishme në efikasitetin operative. Kjo konsiderohet shumë më e drejtë se sa sistemi aktual i kryerjes së pagesave paushall të amvisërive dhe mund të shfaqin përmirësime të dukshme në efikasitetin operative.¹

¹ Siç propozuar në draftin e EPTISA mbi Strategjinë e Mbulimit të Kostos

1 HYRJE

Termet e Referencës specifikojnë që, si pjesë të Përkrahjes Direkte Teknike (seksioni 4.2.2) dhe Përkrahjes për Tarifa, kërkesën për të shqyrtuar dhe llogaritur mundësinë dhe gatishmërinë për të paguar.

Propozimi nga Raporti Fillestar i dorëzuar nga IPA elaboron lidhur me këto aktivitete si vijon:

Mundësia dhe Gatishmëria për të paguar nuk është përmendur në mënyrë specifike në Rregullorët 2004/49 ose Rregullat. Sidoqoftë Rregullat mbi Vendosjen e Tarifave i referohen Ekuitetit Social në Nenin 7: Parimet e Përgjithshme për Vendosjen e Tarifave, siç vijon: “Struktura e tarifave duhet të pasqyroj ekuitetin dhe drejtësinë e shërbimeve dhe çmimeve. Qeveria e Kosovës mund të subvencionoj konsumatorët me të hyra të ulëta përmes pagesave të drejtpërdrejta tek Ofruesi i Shërbimeve në emër të konsumatorit të tillë për shërbimet e ofruara”. Kriteri që duhet të ndiqet nga Rregullatori në shqyrtimin e tij të Tarifave të Shërbimit (shiko Neni 36 i Rregullës për Vendosjen e Tarifave) nuk i referohet mundësisë ose gatishmërisë për të paguar.

Ne propozojmë të ndërmerret një studim shpejtë mbi mundësinë dhe gatishmërinë për të paguar duke përdorur statistikën e qeverisë së Kosovës dhe të OSBE-së me qëllim të krijimit të normave për mundësinë e pagimit në gjithë Kosovën dhe nëse të dhënat janë të gatshme, në secilin prej shtatë regjioneve që marrin shërbime nga kompanitë e ujit dhe mbeturinave. Strategjia e EPTISA për Mbulimin të Shpenzimeve tregon që 1.0 të të hyrave mesatare është pikë fillestare për tarifën e grumbullimit të mbeturinave.

Përcaktimi i nivelit të gatishmërisë për të paguar është sferë subjektive dhe e vështirë që të bëhet – veçanërisht në Kosovë ku disa (por jo të gjithë) nga minoritetet tani nuk paguajnë për shërbimet duke përfshirë energjinë elektrike, ujin dhe mbeturinat duke i ngritur kështu çmimet e komuniteteve që i paguajnë shërbimet. Ne do ta ndërmarrim një studim të kabinetit me një vëllim të limituar të punës në terren nëse është nevoja, me qëllim të përcaktimit të nivelit të gatishmërisë për të paguar në gjithë Kosovën dhe nëse të dhënat janë të disponueshme atëherë për secilin prej shtatë regjioneve që marrin shërbime nga ndërmarrjet e ujit dhe mbeturinave.

Drejtori i ZRRUM-it ka kërkuar që të përfshihen “rastet sociale” në analizën e mundësisë duke përdorur qasjen e njëjtë të pranuar kohën e fundit nga KEK-u në arritjen e marrëveshjes me Ministrinë e Financave mbi kryerjen e pagesave direkte të faturave të energjisë elektrike për 2006 nga Ministria e Financave të KEK-u dhe pastaj edhe të gjitha rastet e regjistruara sociale. Si pjesë e kësaj dhe implikimeve gjatë ndarjes së bazës së të dhënave me KEK-un, kompanitë e ujit dhe të grumbullimit të mbeturinave do të ekzaminohen.

Veç kësaj, diskutimet lidhur shkëmbimin e informative për konsumatorët lidhur me databazën e konsumatorëve të kompanive shërbyese (veçanërisht baza e të dhënave të KEK-ut dhe e kompanive të ujit) janë inicuar me stafin e Gelsenwasser nga “Projekti i Përkrahjes Institucionale për Kompanitë e Ujit në Kosovë” lidhur me Kompaninë Regjionale të Ujit në Prishtinë.

Gjatë muajit Shkurt dhe Mars 2007, udhëheqësi i projektit ka vizituar Kosovën ku ka qëndruar tri javë dhe gjatë kësaj kohe ka ndërmarrë një studim mbi mundësinë dhe gatishmërinë për të paguar në bazë të propozimeve të Raportit Fillestar dhe detyrave tjera që kanë lidhje me tarifën dhe rregulloret. Koha e kushtuar për çështjet e mundësisë dhe gatishmërisë për të paguar ka qenë e kufizuar në dhjetë ditë.

2 BURIMET E TË DHËNAVE

Siç është cekur në Raportin Fillestar, qasja në pjesën e këtij projekti ka qenë e kufizuar në këtë studim me shfrytëzimin e të dhënave të mbledhura nga burimet e ndryshme. Burimet kryesore të të dhënave përdorura janë:

- *Të hyrat private në Kosovë 2003 – 2005*, Enti i Statistikës së Kosovës (2006)
- *Vështrim demografik dhe shëndetësor 2003 – Përfundimet paraprake*, Enti i Statistikës së Kosovës (2004)
- *Statistikat e tregut të punës 2005*, Enti i Statistikës së Kosovës (2006)
- *Kosova në Shifra 2005*, Enti i Statistikës së Kosovës (2006)
- *Konsumi Privat në Kosovë 2003 – 2005*, Enti i Statistikës së Kosovës (2006)
- *Konflikti Etnik dhe Ndryshimi Ekonomik: Serbët dhe Shqiptarët në Kosovë*, Bhaumik, Gang and Yun (2004)
- *Menaxhimi i Mbeturinave*, Shoqata Ndërkombëtare për Mbeturinat e Ngurta (SHNMN) (2004), me analizën e Macfarlane & Rushbrook (1998)
- *Varfëria në Kosovë është shumë e përhapur por mund të bëhen ndryshime*, World Bank News Release 2005/5 (2005)
- *Programi për rehabilitimin e ujësjellësit V – Kosovo, studim socio-ekonomik*, Kittleberger et al (2005 (inferred))
- *Studimi mbi politikën e tarifave – raporti final Hidrodini*, Kittleberger et al (2006)
- *Studimi mbi politikën e tarifave – raporti final Hidroregjioni Jugor*, Kittleberger et al (2006)
- *Të drejtat dhe obligimet e bizneseve që veprojnë në Kosovë*, UNMIK (2001)
- *Kosova – Profili ekonomik*, Komisioni European (<http://ec.europa.eu/cgi-bin/etal.pl>) (2005)
- *Përkrahja e mëtejshme institucionale e ndërmarrjeve të mbeturinave në Kosovë – Raporet themelore* (8 no), Eptisa, (2006)
- (Një pjesë nga) *Faktorët financiar dhe operativ që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve të mbeturinave të ngurta në qytetet e mëdha*, Macfarlane, (1998), (Marrur nga baza e të dhënave të WHO (WHOLIS) doc no EUR/ICP/ENHA 01 01 01)

Përveç shqyrtimit të të dhënave më lartë, konsultanti është takuar me zyrtarë të shumtë të agjencive të ndryshme dhe të projekteve me qëllim të depërtimit në problemet specifike dhe sfidat e sektoreve të ujit dhe mbeturinave.

3 ANALIZA E TË HYRAVE

3.1 Pjesa e përgjithshme

Analizat e mëparshme për mundësinë dhe gatishmërinë për të paguar të bëra nga të tjerët kanë ekzaminuar këto aspekte në bazë të të hyrave mesatare dhe konsumit mesatar. Ky raport nuk i përsërit përpjekjet e kaluara por i shtjellon ato. Në veçanti, kjo analizë ka qasje më të fokusuar mbi modelet e shpërndarjes së të hyrave dhe konsumit me qëllim të identifikimit të shkallës se sa preken të varfërit nga tarifat e shërbimeve dhe çfarë niveli i përkrahjes financiare është i nevojshëm për të varfërit.

Janë bërë llogaritjet e ndryshme të të hyrave të amvisërisë, ku raportet më të mira kanë qenë raportet e Entit të Statistikës së Kosovës për vitin 2004 dhe 2005. Shifrat nga këto raporte janë analizuar me qëllim të përcaktimit të të hyrave mesatare dhe shpërndarjes së tyre sipas popullatës dhe regjionit.

Për qëllimet e kësaj analize, ky raport fokusohet vetëm në popullatën urbane që pranon shërbimet e ujit dhe të mbeturinave.

3.2 Të hyrat mesatare të amvisërisë

Vlerësimi i të hyrave mujore të amvisërisë bëhet në dy mënyra kryesore të marra nga raporti Kosova në Shifra 2005 (T7.1 dhe T7.2), me vitin 2004 që është viti i referimit të të dhënave:

T7.1 vlerëson konsumin mujor mesatar për amvisëritë urbane për 326.50 EURO (përfshirë edhe ushqimin e vetprodhuar prej 3.57 EURO)

T7.2 vlerëson të hyrat mesatare mujore për amvisëritë urbane për 322.93 EURO.

Të hyrat e amvisërisë dhe analizat mbi konsumin shpesh ofrojnë raportime të dobëta të të hyrave për shkak të jogatishmërisë së raportimit të aktiviteteve jozyrtare të të hyrave (për shkaqe të vënies së taksave) dhe zakonisht nuk i përfshijnë tërësisht ndikimet e pagesave shtesë siç është puna jashtë orarit etj. Praktikë e zakonshme është fokusimi në konsumin si tregues i të hyrave se sa në të hyrat e raportuara; në këtë rast nuk ka diferencë materiale. Megjithëse nuk ka të dhëna që e mbështesin këtë, nivelet e të hyrave pritet që të jenë pak më të larta se nivelet e konsumit.

Sidoqoftë, analizat e bëra kanë të bëjnë me të hyrat neto të disponueshme dhe i përjashtojnë taksat dhe kursimet. Rreth 65% të të hyrave mesatare përfshijnë të hyrat nga pagat e tatueshme. Sipas rregulloreve aktuale të taksave dhe pensioneëve, të hyrat bruto të amvisërive, mbi të cilët janë të bazuar indikatorët e mundësisë së krahasimit (benchmark), mesatarja e të hyrave bruto të amvisërisë në nivelet e çmimit të vitit 2004 është llogaritur të jetë përafërsisht 341.00 EUR.

Nivelet e tilla të të hyrave duhet të rregullohen për efektet e inflacionit dhe rritjes ekonomike. Efektet e inflacionit të bazuara në shkallën mesatare të inflacionit për periudhën të mesit të vitit 2004 dhe të mesit të vitit 2007 (tri vite) kanë qenë përafërsisht 2.0 deri 2.5 % në vit (supozojmë mestarja prej 2.2)

Llogaritë kombëtare për Bruto Produktin Vendor për rritjen e popullatës në Kosovë nuk tregojnë rritjen e të hyrave të amvisërisë për shkak të nivelit të lartë të rrjedhjes kapitale. Sidoqoftë, Komisioni European (Profili Ekonomik i Kosovës, 2005) vlerëson rritjen e Bruto Produktit Vendor (real) në mesatarën prej mbi 3 % gjatë periudhës 2003 – 2005. Faktorimi në shkallën e raportuar të rritjes vjetore të popullatës prej 1.7 % për rritjen e numrit të banorëve (real) është vlerësuar të jetë 1.3 %.

Një burim alternativ, dokumenti SOK, Konsumi Privat në Kosovë 2003-2005, sugjeron që konsumi për banor në mes të vitit 2003 dhe 2005 është rritur për 13% (nominal). Duke pasur parasysh inflacionin, shifrat e konsumit sugjerojnë të hyrat reale për shkallën e rritjes së numrit të banorëve prej 4.0 % në vit.

Për qëllimet e kësaj analize, pika mesatare këtyre dy vlerësimeve (2.7%) merret si të hyrat (reale) për rritjen e numrit të banorëve gjatë kësaj periudhe dhe ka vazhduar në këtë shkallë deri kah mesi i 2007. Me inflacionin dhe për rritjen e numrit të banorëve, të hyrat bruto të amvisërive (para taksave dhe kursimeve) vlerësohen të jenë rritur nga 341.00 EUR në mesin e vitit 2004 në përafërsisht 376.00 kah mesi i vitit 2007.

Për qëllimet e kësaj analize, mesatarja e të hyrave mujore supozohet të jetë 376.00 EUR për 2007.

3.3 Klasifikimi i të hyrave sipas amvisërive

Edhe pse Kosova konsiderohet vend i varfër sipas standardeve Europiane, niveli i varfërisë nuk është edhe aq i madh. Bhaumik, Gang dhe Yun (*Konflikti Etnik dhe Ndryshimi Ekonomik: Serbët dhe Shqiptarët në Kosovë, (2004)*), vlerëson që koeficienti Gini për Kosovën të jetë 0.29. Kjo rezulton në klasifikimin e përafërt të të hyrave me të hyrat mesatare siç është ilustruar në Figurën 1.




Figura 1 – Shpërndarja e vlerësuar e të hyrave të amvisërisë

Kjo analizë sugjeron që të hyrat mesatare të 10 % të amvisërive të varfëra është vetëm nën 20 % të mesatarës së përgjithshme.

3.4 Klasifikimi i të hyrave sipas regjionit gjeografik

Këto janë të dhëna të pakta mbi klasifikimin gjeografik të të hyrave. I vetmi tregues është Tabela 10.8 (Kosova në Shifra 2005) për pagat mesatare sipas regjionit. Analiza e kësaj të dhëne ka rezultuar në klasifikimin e pagave sipas regjionit siç është paraqitur në Tabelën 1:

Tabela 1 – Pagat mesatare sipas regjionit

Regjioni	Paga mestare si % e mesatarës kombëtare
Ferizaj	103%
Gjakovë	106%
Gjilan	82%
Mitrovicë	102%
Pejë	105%
Prishtinë	104%
Prizren	99%

Për qëllimet e këtij studimi supozohet që të hyrat mesatare të amvisërisë për secilin regjion ndryshojnë sipas përqindjeve të ilustruara më lartë.

3.5 Definicioni i të varfërve

Vlerësimi i varfërisë i Bankës Botërore të Kosovës (2005) konstaton:

‘Në 2002, rreth 37% të popullatës ka jetuar nën vijën e varfërisë prej 1.42 EUR / për person të rritur në ditë

‘Popullata që jeton nën vijën ekstreme (të ushqimit) të varfërisë prej 0.93 EUR për person të rritur në ditë që është vlerësuar të jetë 15%’

Bhaumik, Gang and Yun, *Konflikti Etnik dhe Ndryshimi Ekonomik: Serbët dhe Shqiptarët në Kosovë*, (2004) konstatojnë:

‘. . . që në Kosovë, në 2000, 56.7 përqind të amvisërive serbe dhe 45.9 përqind të amvisërive shqiptare kanë jetuar nën vijën e varfërisë.’

Kittleberger et al, *Programi për rehabilitimin e ujësjellësit V – Kosova, Studimi socio-ekonomik*, (2005) konstaton:

‘. . mbi rreth 25.6 % të të gjithë amvisërive në mostër, konsiderohen si të varfëra (8.7% si jashtëzakonshisht të varfër, 16.9% si shumë të varfëra . .

‘Të dhënat e të hyrave nga studimi i njëjtë tregojnë që në mes të 21.3 dhe 40.8% të amvisërive gjenden në kategorinë e të varfërve dhe minimumi i 9.7% hyjnë në kategorinë e “shumë të varfërve”.

Analiza SOK “Kosova në Shifra 2005” nuk e definon varfërinë por jep shifra për familjet që kanë marrë ndihmë sociale në vitin 2004, që mund të interpretohet si definicioni i dhënë i qeverisë për ‘varfëri’. Ekstrapolimi i shifrave të paraqitura në këtë raport tregon që mbi popullatën e tërë të Kosovës, vija e varfërisë barazohet me më shumë se 8% të amvisërive (8.4% në shtrirjen e mesatarës nga 5.6% për Prizrenin deri 11.0% për Prishtinën).

Me rritjen ekonomike në mes të vitit 2002 (vlerësimet e Bankës Botërore) dhe 2004, është e arsyeshme të supozohet që gjendja e varfërisë është përmirësuar gjatë kësaj periudhe, pa ndonjë argument mbështetës por në bazë të të dhënave të disponueshme, të papërcaktuara.

Përdorimi i analizës së shpërndarjes së të hyrave të paraqitura në Kapitullin (t²) sugjeron që përqindja e popullatës që jeton nën vijën e varfërisë prej 1.57 EUR në ditë (1.42 EUR të përshtatur me inflacionin e Euro-zonës të 2% gjatë periudhës 2002 – 2007) sugjeron që përafërsisht 20 % të popullatës urbane aktualisht është nën vijën e varfërisë³. 10 % të

² 10% mesatarja me shtrirje prej 9% për të gjithë përveç Gjilanit 13%.

³ 19% mesatarja me shtrirje prej 18% to 25%.

popullatës është e prekur me varfërinë ekstreme (të ushqimit) që është nën 1.03 (0.93 EUR të përshtatura për inflacionin) dhe që lidhet ngushtë me numrin e familjeve që marrin ndihmë sociale.⁴

Për qëllimet e kësaj analize supozohet se personat që janë shumë të varfër, të definohen si 20 % të më të varfërve dhe ata që janë më të varfër të definohen si 10% të më të varfërve të popullatës.

⁴ 10% mesatarja me shtrirje prej 9% për të gjithë përveç Gjilanit 13%.

4 KËRKESA E UJIT PËR AMVISËRITË DHE ANALIZA E MUNDËSISË

4.1 Kërkesa mesatare

Shifrat nga regjistrat e raportimit të ZRRUM-it kanë zbuluar kërkesat⁵ e vlerësuara vendore të ujit. (litër për banor në ditë) dhe m³ për amvisëri në muaj⁶ të ilustruara në Tabelën 2.

Tabela 2 – Konsumi i vlerësuar për banor dhe konsumi i ujit në amvisëri

Kompania	Litra për banor në ditë	m ³ për amvisëri në muaj
Prishtina	79.8	13.2
Prizren	76.4	12.6
Pejë	109.8	18.1
Mitrovicë	63.4	10.5
Gjakovë	99.3	16.4
Ferizaj*	33.7	5.6
Gjilan	67.0	11.1
Èighted average	76.0	12.5
<i>(excluding Ferizaj)</i>	<i>79.7</i>	<i>13.2</i>

* Kërkesa e vlerësuar për Ferizajin është disproporcionalisht e ulët dhe mund të mos përfillet pasi që është jo e besueshme për qëllimet e kësaj analize.

Rezultati i kësaj analize (me përjashtim të Ferizajit) është real dhe krahasohet me pritjet e kërkesave të amvisërisë për furnizimin me ujë të zonave urbane ku jeta në banesa është normë. Për qëllime të kësaj analize, kërkesa e vlerësuar për banor për Ferizaj supozohet të jetë mesatarja e këtyre duke e përjashtuar Ferizajin.

4.2 Përshtatshmëria e të hyrave të kërkesës së ujit

Krahasimi i kërkesave mesatare me të hyrat mesatare nuk tregon lidhje statistikore të rëndësishme edhe pse kjo nuk do të thotë që nuk ka përshtatje të të hyrave të kërkesës.

Nuk ka të dhëna të disponueshme që mundësojnë vlerësimin real të potencialit për kërkesën e ulur nga amvisëritë me të hyrat e ulëta. Sidoqoftë, studimet e bëra në vende tjera, në mjedise të ngjajshme urbane siç është Romania sugjerojnë që përshtatshmëria e të hyrave të kërkesës mund të jetë prej 0.5 deri 0.7. Për qëllime të kësaj analize është sugjeruar që vlera duhet të jetë 0.5, p.sh. për 10 % të reduktimit në të hyrat e amvisërisë, 5% të reduktimit mund të pritët. Mund të ketë nivel të ulët të kërkesës të bazuar në nevojat minimale, të themi 50 l për banor në ditë (8.5 m³ për amvisëri në muaj për mesataren prej 5.5 personave).

Në bazë të këtyre parametrave, 10 % i popullatës (sipas të hyrave) duhet në mënyrë efektive të përdorin minimum nivelin prej 50 litra për banor në ditë. Për Gjilanan dhe Mitrovicën, ky nivel i ulët mund të prek përafërsisht 20% të popullatës⁷ dhe për Gjakovën dhe Pejën, kërkesat për të varfërit mund të jenë mbi nivelin e ulët prej 50 litrave për banor në ditë.

⁵ Siç është propozuar në draftin e EPTISA mbi Strategjinë e Mbulimit të Kostos

⁶ Siç është propozuar në draftin e EPTISA mbi Strategjinë e Mbulimit të Kostos

⁷ Rezultatet për Ferizajin janë të diskutueshme pasi që të dhënat konsiderohen sit ë pasigurta

4.3 Përshtatshmëria e çmimit të kërkesës

Nuk ka të dhëna të disponueshme për përcaktimin e përshtatshmërisë së çmimit të kërkesës. Supozohet, sidoqoftë, që kryesisht mënyra urbane e jetesës në banesa në Kosovë lënë mundësi që kërkesa e ujit të preket nga efektet e çmimit sidomos vendet e varfëra ku supozohet që nivelet e konsumit të ujit janë të ulëta. Mund të ketë efekt të përshtatshmërisë së çmimit në vendet më të pasura por kjo nuk është pjesë e analizës së mundësisë. Kudo në botë që është bërë vlerësimi i përshtatshmërisë së kërkesës, normalisht është treguar i ulët, prej 0.3, p.sh. 10% të rritjes në çmim do të rezultojë në 3% në reduktim të kërkesës. Sidoqoftë, studimet e tilla sugjerojnë që efektet e përshtatshmërisë së çmimit janë më të mëdha në shkallën e të hyrave ku kapaciteti është i madh për uljen e konsumit. Për qëllimet e kësaj analize, efektet e përshtatshmërisë së çmimit për të varfërit nuk janë marrë parasysh.

4.4 Kostot e shërbimit

Tarifat aktuale për furnizimin me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza të konsumatorëve shtëpiak janë paraqitur në Tabelën 3.

Tabela 3 – tarifat vendore të ujit

Kompania	Tarifa fikse (EUR / muaj)	Ngarkesa volumetrike për ujë (EUR/m ³)	Ngarkesa volumetrike për ujëra të zeza (EUR/m ³)
Prishtina	1.00	0.25	0.05
Prizren	1.00	0.17	0.05
Pejë	1.00	0.15	0.05
Mitrovicë	1.00	0.26	0.05
Gjakovë	1.00	0.25	-
Ferizaj	1.00	0.25	0.07
Gjilan	1.00	0.25	0.05
Mesatarja	1.00	0.23	0.05

Shënim: tarifat e lartpërmendura janë pjesë e tatimit mbi vlerën e shtuar me shkallë prej 15% që duhet të mirret parasysh gjatë përcaktimit të niveleve të mundësisë.

Është me rëndësi të dihet që tarifat janë të bazuara në analizat e tarifave të thjeshtësuara që nuk janë prekur nga mbulimi i plotë i koston, veçanërisht nga kostoja e plotë aktuale e zhvlerësimit (ose tarifave e ekuivalente të infrastrukturës) dhe as që nxirren nga kthimi në kapital. Kjo është jashtë kornizës së kësaj analizës së mundësisë që të ekzaminohet shkallën e mbulimit të shpenzimeve por është e nevojshme që këto tarifa të mirren parasysh. Ngarkesat volumetrike për furnizimin me ujë në industrinë e privatizuar por jo aq të rregulluara të furnizimit të ujit në Angli dhe Uells, ku mbulimi i koston është i plotë dhe ku kthimi në kapital për investitorët fitohet, që shtrihet nga 1.70 EUR deri 2.30 EUR në m³ për konsumatorë shtëpiak. Edhe duke marrë parasysh diferenciat e koston në shërbime dhe zero kthimin në kapital, kuptohet se tarifat aktuale në Kosovë janë më të ulëta se koston e vërteta të shërbimeve dhe do të ishte e paarsyeshme që të priten, në afat më të gjatë, rritje katërfishtë e çmimit (ose më shumë) për të arritur mbulimin e plotë të koston.

4.5 Mundësia

Kryesisht është i pranueshëm parimi që pragu i përballueshmërisë për shërbimet e furnizimit me ujë është 3 – 4 % i të hyrave mesatare të amvisërisë. Gjithashtu dihet se duke u bazuar në mesataret e tilla, nga sektori më i dobët mund të kërkohej të paguajmë më shumë si një përqindje të të hyrave të tyre. Nuk ka ndonjë rregull sa i përket asaj se çfarë nivele të pragut duhet të jenë për sektorin por të dhënat empirike sugjerojnë që tarifat e shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza për të varfërit mund të shpenzojnë 6% të të hyrave të amvisërisë (ndonjëherë të larta sa 10%, në raste ekstreme). Për të varfëritë në Kosovë, kjo analizë duhet të pranoj pragun prej 5% të të hyrave të amvisërisë të shpenzohet për furnizim me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza. Për qëllimet e krahasimit, analiza gjithashtu shqyrton ndikimin nëse pragu i përballueshmërisë për të varfëritë është i njëjtë me mesatarën, p.sh. 3% të të hyrave të amvisërisë. Rezultatet e kësaj analizës janë të ilustruara në Tabelën 4.

Tabela 4 – Përqindja e popullatës që nuk është gjendje t'i kryej pagesat për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Kompania	Popullata që nuk është në gjendje t'i përmbush tarifat aktuale bazuar në 5% të të hyrave të amvisërisë	Popullata që nuk është në gjendje t'i përmbush tarifat aktuale bazuar në maks. prej 3% të të hyrave të amvisërisë
Prishtina	6.0	11.1
Prizen	5.1	8.4
Pejë	5.3	9.6
Mitrovicë	6.2	10.8
Gjakovë	5.8	13.3
Ferizaj	6.3	12.5
Gjilan	7.6	15.3
Mesatarja	5.8	10.0

Me anë të interpolimit, përafërsisht 8% të popullatës nuk mund të jetë në gjendje të paguaj për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në nivelet aktuale të tarifave nëse pragu i përballueshmërisë është vendosur në 4% të të hyrave të amvisërisë. Kjo analizë sugjeron që amvisëritë të cilat janë klasifikuar si raste sociale (8.4% të popullatës totale por ndoshta shumë më pak për amvisëritë urbane ku të hyrat janë, sipas mesatarës, më të mëdha) janë ato amvisëri për të cilat pritet që pagesat e tarifave të ujit të jenë problematike. Kjo e përforcon situatën ku përkrahja e qeverisë duhet të ipet këtyre amvisërive për të paguar faturat e tyre të ujit, përmes pagimit direkt kompanive ose përmes përkrahjes financiare plotësuese të amvisërive.

Me analizën e mëtejshme, është e mundur të përcaktohen rritjet e tarifave të cilat mund të sigurohen nga 80% e popullatës që do të thotë që 20% i popullatës do t'i nevojitet përkrahja financiare siç është ilustruar në tabelën 5.

Tabela 5 – Tarifatat e vendosura në nivelin e mundësisë të 20% të popullatës

Kompania	Tarifa (EUR / m ³) e bazuar në nivelin e pragut prej 5% të të hyrave të amvisërisë (% rritje tarifave ekzistuese)		Tarifa (EUR / m ³) e bazuar në nivelin e pragut prej 3% të të hyrave të amvisërisë (% rritje tarifave ekzistuese)	
Prishtinë	0.76	(154%)	0.42	(41%)
Prizen	0.75	(243%)	0.42	(89%)
Pejë	0.56	(182%)	0.31	(56%)
Mitrovicë	0.90	(189%)	0.50	(60%)
Gjakovë	0.63	(150%)	0.35	(39%)
Ferizaj	0.76	(137%)	0.42	(31%)
Gjilan	0.70	(132%)	0.37	(25%)
Mesatarja	0.73	(171%)	0.41	(49%)

Këtu kemi koncesion në mes të sigurimit të kompanive me tarifa që i shpian ato deri të mbulimi i plotë i kostos përderisa në të njëjtën kohë sigurohet ndihma më e madhe për të varfërit ose vendosen tarifa në nivelet e mundësisë por që ngadalson procesin në drejtim të mbulimit të plotë të kostos. Në çfarëdo mënyre përkrahja e qeverisë do të nevojitet për subvencionuar konsumatorët e varfër ose të financojë the gap (hendekun) në mes të niveleve aktuale të të hyrave dhe mbulimit të plotë afatgjatë, normalisht përmes financimit të kërkesave të investimit në kapital. Ky është vendim i politikave të qeverisë për të cilët është edhe strategji e preferuar. Në mënyrë ideale, bilanci duhet të jetë në atë nivel që do të kushtoj më pak p.sh. ku efekti i neto subvencionit është më i ulët. Është jashtë analizës së mundësisë që të përcaktoj se çka është kjo pika e barazimit por thjeshtë kontrollimi i rezultateve sugjerojnë që rritjet e tarifave ekzistuese dhe përhapja e nivelit të përkrahjes konsumatorëve, të themi 20% , mund të jenë më frytdhënëse se status quo-a. Ky nuk është një vendim për ZRRUM-in të bëjë ose ndoshta të rekomandoj por vendim për Qeverinë e Kosovës me anë të cilit ZRRUM-i duhet të implementoj fuqitë dhe procedurat e tij.

4.6 Gatishmëria për të paguar

Pa rezultate të analizës së hollësishme të vlerësimit nuk është e mundur të përcaktohet niveli i gatishmërisë për të paguar për furnizimin me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza. Studimi i fundit, Programi për rehabilitimin e furnizimit të ujit në zona urbane V – Kosova, Studimi Socio-Ekonomik, Kittleberger (2005) tentoi të përcaktoj shkallën e gatishmërisë për të paguar por rezultatet në njëfarë mënyre, nuk ishin përfundimtare. Ky raport sa i përket mundësisë për të paguar, përfshinë:

‘ . . 22% do të jenë të gatshëm të paguajnë më shumë për ujë nëse shërbimet përmirësohen dukshëm nga furnizuesi. ’

‘ . . 43.6% kanë thënë që nuk do të pajtohen të paguajnë më shumë edhe nëse shërbimet do të përmirësohen

‘ . . (ata që janë të gatshëm për të paguar më shumë) Mesatarja do të ishte 7.11. EURO ’

‘ . . Gatishmëria e amvisërive për të paguar tarifatat e larta për furnizimin e përmirësuar të ujit dhe shërbimet e ujërave të zeza është e kufizuar. Ata të cilët kanë furnizimi të dobët ose shërbime të dobëta të kanalizimit janë më të gatshëm që të paguajnë më shumë se të tjerët ’.

Nuk është e mundur që të përcaktohen efektet e çfarëdo rritje të propozuar të tarifave në bazë të të dhënave të lartpërmendura.

Të dhënat e vetme të qarta lidhur me gatishmërinë për të paguar janë ato të performancës së inkasimit të kompanive siç janë të paraqitura në Tabelën 6.

Table 6 – Performanca e inkasimit (si përqindje e shumës së faturuar)

Kompania	2005	2006 (Jan – Tet)	Mesatarja
Prishtinë	37%	44%	41%
Prizren	64%	50%	57%
Pejë	45%	42%	44%
Mitrovicë	33%	28%	31%
Gjakovë	70%	66%	68%
Ferizaj	61%	49%	55%
Gjilan	58%	58%	58%
Mesatarja	48%	47%	48%

Rezultatet më lartë janë të dobëta (ne nivel te larte) në krahasim me ato më të zhvilluara të ofruesve të shërbimeve të kompanive kudo tjetër në botë. Analiza e mundësisë sugjeron që shifrat aq të ulëta të inkasimit nuk mund t'i atribuohen pengesave të mundësisë që pritet të jenë prej 5% deri 10% të faturimit total. Forcat e tjera padyshim ndikojnë në modelin e pagesës. Nuk ka të dhëna mbështetëse se çfarë mund të jenë këto forca dhe kurfarë konkludimi nuk mund të mirret në këtë fazë. Sidoqoftë, vlerësimi subjektiv i bazuar në opinione jozyrtare të shprehura nga palët e ndryshme sugjeron që shkaqet e mos-pagimit mund t'i atribuohen shumë arsyeve duke përfshirë:

- Niveli i shërbimeve në shumicën e rasteve mund të jetë aq i ulët sa që konsumatorët e kundërshtojnë pagesën për shkak se ata nuk ndihen se ata kanë dobi nga kjo.
- Procedura gjatë së cilës konsumatorët i paguajnë faturat e tyre mund të jetë e paërshtatshme dhe konsumatorët që ndoshta kanë qenë të gatshëm për të paguar, mund të vendosin që mos të paguajnë pasi që ajo kërkon një nivel joproporcional të përpjekjes lidhur me vlerën e faturës.
- Imponimi i sanksioneve, veçanërisht shkyçjet, mund të limitohen, nëse nuk është e pamundur, kur ka të bëjë me shërbimet e ndara dhe kur njëra nga palët nga shërbimet e ndara nuk i kryen obligimet. Kjo është e theksuar në banesa ku shërbimi ofrohet përmes kyçjeve të veçanta dhe matësit aty ku nuk është e mundur të shkyçen amvisëritë individuale. Kjo mund të ketë efekt kumulativ ku të tjerët të cilët zakonisht janë të gatshëm të paguajnë, nuk e bëjnë këtë sepse të tjerët përreth tyre nuk paguajnë.
- Mund të ketë gatishmëri të kufizuar për të bërë inkasimin e të hyrave nga konsumatorët, sidomos kur faturat mund të jenë aq të ulëta që nuk mund të ndikojnë në përpjekjen e përfshirë në inkasimin dhe përforsimin.
- Mund të ketë ngurrime në pagimin e faturave të kompanisë nga grupet etnike që mund të shkaktojnë efekt sekondar në grupet e tjera të cilët e shohin si jo të arsyeshme të paguajnë nëse të tjerët nuk paguajnë dhe për këtë nuk dënohen (shkyçjet dhe sanksionet e tjera).

Të gjitha këto çështje nuk janë 'rregullative' por më tepër kanë të bëjnë me përgjegjësinë e menaxhimit të kompanive. Megjithatë, ZRRUM-i duhet të përpiqet të ndihmojë iniciativën me qëllim të përmirësimit të gjendjes duke përfshirë:

- Strategjinë intensive të komunikimit, që është në pajtim me ato të kompanive, me qëllim të informimit të konsumatorëve mbi rëndësinë e pagimit të shërbimeve dhe për implikimet me të cilat do të përballen me rast të mos-pagimit.

- Lobimin te qeveria ku ndryshimet e instrumenteve ekzistuese ligjore (ose të instrumenteve të reja) janë të nevojshme për siguruar performancën e përmirësuar të inkasimit.
- Inkurajimin/përkrahjen e iniciativave menaxhuese dhe projekteve stimuluese duke përfshirë pjesëmarrjen e sektorit privat në inkasimin edhe në shërbimet e tjera.
- Vendosjen e caqeve reale por megjithatë sfiduese për performancën e inkasimit në procesin e përcaktimit të tarifave dhe stimulimin e performancës së mire dhe destimulimin e performancës së dobët që lidhet me këto caqe.

4.7 Mekanizmat e Përkrahjes

Rregullorja 2004/49 10.3 (f) sugjeron ‘..përgjegjësia e Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes, jo e ofruesve të shërbimeve, është të ndihmoj Kosumatorëve me të ardhura të ulëta, të paguajnë faturat e tyre.’. Kjo nuk duket që do t’i obligoj këto institucione që t’i përmbushin këto tarifa. Sidoqoftë, precedenti është bërë nga subvencionet e qeverisë për Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) me shumën prej 4.5 milion nga buxheti kombëtar. Supozojmë që subvencionet e tilla janë të drejtuara familjeve me të ardhura të ulëta në Kosovë (urbane dhe rurale) dhe janë të kufizuara në 10% të popullatës atëherë subvencionet e tilla barazohen me përafërsisht 8.00 EUR deri 10.00 për amvisëritë e varfëra në muaj. Duke patur parasysh shërbimet minimale prej 50 litra për banor në ditë për 10 % të amvisërive të varfëra atëherë fatura mujore e amvisërive do të ishte prej 3.30 EUR deri 3.50 EUR në muaj. Për popullatën totale urbane në Kosovë, kjo do të barazohej me përafërsisht 1.2 milion EUR në vit, që është përafërsisht një çerek të subvencioneve vjetore të dhëna KEK-ut. Nëse kjo përkrahje shtrihet te të varfërit 20% të popullatës urbane atëherë do të nevojiten 2.5 milion EUR.

Ndikimi i përkrahjes së tillë për kompanitë do të zbresin llogaritë e arkëtueshme. Subvencioni (për më të varfërit 10%) do të paraqes përafërsisht 8% të faturimit të ujit. Supozojmë që të gjitha amvisëritë e varfëra aktualisht nuk paguajnë faturat e tyre të ujit atëherë kjo do të rris efektivisht mesatarën e inkasimit nga niveli i tij aktual të 48% të faturimit deri më shumë se 55%. Ndikimi në performancën e përgjithshme të inkasimit do të ishte i ulët, nga mesatarja prej 56% deri te më shumë se 60% por megjithatë do të mundësoj që tarifat të jenë më të ulëta se sa do të duheshin të jenë.

Nëse qeveria shkon në këtë drejtim atëherë mbi atë se si janë administruar fondet e tilla nuk do të ketë kontrollera strikte duke përfshirë:

- Vendosjen e një sistemi të regjistrimit (të bazuar në strukturën aktuale të regjistrimit të rasteve sociale) përmes të cilit konsumatorët mund të identifikohen dhe të regjistrohen në sistemin e faturimit. Nuk do të jetë e mundur që në fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe rregullave, baza e të dhënave të KEK-ut të kalojë në kompanitë e ujit. Sugjerohet se përgjegjësia të jetë e konsumatorëve që të aplikojnë në kompanitë për përkrahjen dhe të sigurojnë dokumentacionin për aplikimin për këtë përkrahje se sa të llogarisin në sistemin e bazës së të dhënave që mund të mos jenë në pajtim me sistemet e faturimit të konsumatorëve.
- Regjistrimi duhet të bëhet në bazë të rregullt, p.sh. një herë në vit, pasi që konsumatorët mund të largohen nga varfëria dhe më mos të kenë nevojë për ndihmë.
- Kufizimin e shumës së pagesave në nevojat bazike dhe mospërdorimi i tepëruar i ujit. Kjo do të sjell përshtatje në sistemet e faturimit p.sh. për faturat të refelktojnë përkrahjen e dhënë por çdo faturim shtesë mbi nevojat bazike prapë do të jenë përgjegjësi e konsumatorëve për të paguar.

5 GRUMBULLIMI I MBETURINAVE TË AMVISËRISË / ANALIZA E MUNDËSISË SË DEPONIMIT

Grumbullimi i mbeturinave/analiza e mundësisë së deponimit është më e thjeshtë se ajo e furnizimit të ujit për shkak të uniformitetit të çmimit për amvisëritë pavarësisht nga vëllimi i mbeturinave të gjeneruara.

5.1 Kosto e shërbimeve

Kostoja e shërbimeve të konsumatorëve shtëpiak që është në ndikim prej 1 Qershor 2006 është e paraqitur në tabelën 7.

Tabela 7 – Tarifat e grumbullimit të mbeturinave (EUR / muaj) (2005) për amvisëritë

NP	Regjioni	EUR/ muaj / amvisëritë (përfshirë TVSH)
Pastrimi	Prishtinë	3.50
Eko-Regioni	Prizen	4.20
Ambienti	Pejë	3.50
Uniteti	Mitrovicë	3.50
Çabrati	Gjakovë	4.30
Pastërtia	Ferizaj	4.30
Higjiena	Gjilan	4.30

Brenda secilës sferë të përgjegjësisë të ofruesit të shërbimeve nuk ka ndonjë variacion të çmimit në mes të kategorive të ndryshme të amvisërive sipas tipit të shtëpive ose lokacioneve as që ka variacione të çmimit që varen nga sasia e mbeturinave të prodhuara.

Të hyrat e shtuara nga këto tarifa pritet t'i mbulojnë shpenzimet e grumbullimit të mbeturinave dhe shpenzimet e deponimit për të cilat ndërmarrja deponuese paguan kompanisë deponuese (Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë) (KLMC)).

Shqyrtimi i mëtejshëm të analizave të EPTISA sugjeron që rritjet të shumë kompanive kërkojnë për mbulimin e plotë të kostos duke u bazuar në performancën e vitit 2005 të inkasimit. (Tabela 8). Eko-Regioni dhe Pastërtia funksionojnë me mbulimin e plotë të kostos.

Tabela 8 – Tarifat e vlerësuara me mbulim të plotë të kostos dhe rritjet e kërkuara

NP	Regjioni	Tarifat e supozuara të mbulimit të plotë të kostos (EUR/amv./muaj)	% rritje në tarifat aktuale
Pastrimi	Prishtinë	6.56	87%
Eko-Regioni	Prizen	4.17	-1%
Ambienti	Pejë	8.08	131%
Uniteti	Mitrovicë	10.65	204%
Çabrati	Gjakovë	5.18	20%
Pastërtia	Ferizaj	4.44	3%
Higjiena	Gjilan	6.10	42%

Shërbimet e grumbullimit ofrohen nga ndërmarrjet publike të grumbullimit të mbeturinave.⁸ Ofruesit e shërbimeve të grumbullimit dhe KLMC operojnë nën nivelin e mbulimit të plotë të kostos dhe kërkojnë subvencione për të ofruar nivele aktuale të shërbimit. Sidoqoftë, tarifat që janë të nevojshme për mbulimin e plotë të kostos pasqyrojnë nivelet e dobëta aktuale të inkasimit (Tabela 9). Sipas analizave të EPTISA, në të gjitha rastet, mbulimi i plotë i kostos mund të arrihet me tarifat që janë kryesisht nën nivelet aktuale, prej 2.20 EUR – 3.20 EUR përfshirë TVSH. Nëse inkasimi është 100%. Një fushatë intensive e komunikimit është më së e nevojshme me qëllim që të informoj popullatën për implikimet me rastin e mos-paguesës të shërbimeve e sidomos për faktin që mbulimi i plotë i kostos nën tarifat aktuale është i mundshëm por në nivelet aktuale të tarifave për ata që paguajnë do të duhen të përballin çmimet më të larta. ZRRUM-i gjithashtu mund të ndihmojë fushatës si një prej strategjive të veta të komunikimit.

5.2 Mundësia

Përvojat e vendeve tjera të botës (Macfarlane & Rushbrook, 1998) sugjerojnë që shpenzimet të mbeturinave për banor barazohen përafërsisht me 0.5% të Bruto Produktit Kombëtar (BPK) për banor. Me mungesën e të dhënave për BPK, vlerësimi i parë, i përafërt i Bruto Produktit Vendor (BPV) për banor prej 1000.40 (të dhënat 2004) është përdorur në këtë analizë. Duke pasur parasysh BPV (real) të vlerësuar për rritjen e numrit të banorëve dhe 5.5 persona për amvisëri, supozohet se BPV për amvisëri të jetë përafërsisht 480.00 EUR në muaj. Si pasojë e kësaj, në bazë të 0.5% të BPV, pritjet që shpenzimet mujore të mbeturinave ndaj mesatarës të jetë 2.40 EUR, me TVSH e barabartë me 2.76 EUR, mesatarja e tarifave të përcaktuara nga EPTISA nëse inkasimim ka qenë afër 100% të faturimit.

Kjo vlerë prej 0.5% të BPK nuk duhet të paraqes nivelin e pragut të përballueshmërisë por duhet të paraqes pritjet e shpenzimeve të mbeturinave të lidhura me ekonominë kombëtare. Nuk ka tregues të sigurt për nivelet e pragut të përballueshmërisë për shërbimet e mbeturinave, megjithëse 1 % i të hyrave mesatare të amvisërisë janë përmendur në analizat e EPTISA. Në bazë të kësaj, për tarifat mujore të amvisërisë prej 3.76 EUR (përfshirë TVSH) duket se nivel i pragut të përballueshmërisë të jetë nën nivelin e mesatarës aktuale të tarifave.

Siç duke, me sistemin uniform të tarifave, kostoja si përqindje e të hyrave të amvisërive do të ishte shumë më e lartë për më të varfërit, mundësisht sa 5 % të të hyrave të amvisërisë, niveli me të cilin rezistenca për të paguar mund të pritjet. Ndërmarrjet Publike mund të konsiderojnë kriterin alternativ të çmimit që më shumë reflekton të hyrat e amvisërive dhe të mbeturinave të prodhuara, p.sh. në banesa të vendosen tarifa më ulëta se në shtëpitë.

Mekanzimi alternativ dhe tjetri që përdoret në shumë ekonomi është për shpenzimet e grumbullimit të mbeturinave dhe deponimit që të financohen përmes regjimit vendor të tatimit në prone. Sistemi aktual i tatimit në prone është i bazuar në fushën e çdo prone. Me ngritjen sistemit të tatimit në prone për të mbuluar në mënyrë efektive shërbimet e mbeturinave, sigurohet sistemi më i drejtë i çmimit, d.m.th amvisëritë më të pasura që kanë gjenerim më të madh të mbeturinave se amvisëritë e varfëra, do të paguajnë më shumë për tatim. Në anën tjetër, amvisëritë më të varfëra në mënyrë efektive do të paguajnë shumat më të vogla se sa është kërkuar nga ato me anë të sistemit aktual uniform të çmimit. Ky plan institucional është rekomanduar në raportin e EPTISA 'Përkrahja e mëtejshme institucionale për kompanitë e mbeturinave të ngurta në Kosovë (2006)', por ka nevojë të bëhen amendamente të rëndësishme të dokumenteve ligjore dhe për strukturat e reja institucionale. Gjithashtu është me rëndësi të dihet që tarifat aktuale

⁸ Ndërmarrjet e mbeturinave janë të klasifikuara zyrtarisht si Ndërmarrjet Publike (POE).

për shërbimet e mbeturinave janë më të larta se mesatarja e tatimit në prone amvisërive. Dyfishimi efektiv (ose më shumë)⁹ të tatimit për të mbuluar shërbimet e mbeturinave mund të mos përkrahen nga autoritetet komunale edhe nëse ndikimet tek të varfërit janë më të favorshme se sa status quo-a.

5.3 Gatishmëria për të paguar

Indikatori kryesor të gatishmërisë për të paguar është performanca e inkasimit siç është ilustruar në Tabelën 9 (Burimi: Raportet themelore Eptisa).

Tabela 9 – Performanca e inkasimit të NP

NP	Regjioni	Inkasimi 2005 (%)
Pastrimi	Prishtinë	42%
Eko-Regioni	Prizen	52%
Ambienti	Pejë	40%
Uniteti	Mitrovicë	27%
Çabrati	Gjakovë	56%
Pastërtia	Ferizaj	58%
Higjiena	Gjilan	52%

Analizat e EPTISA sugjerojnë që pengesa kryesore të inkasimit në sektorin e mbeturinave është mungesa e mekanizmave të efektshëm të përforsimit. Në raste të shtëpive individuale, pagesat për grumbullimin e mbeturinave janë të detyrueshme pasi që mos pagimi mund të rezultojë në atë që mos të bëhet grumbullimi i mbeturinave. Sidoqoftë, për shumicën e amvisërive që jetojnë në banesa, masat e tilla nuk janë të disponueshme për NP pasi që mbeturinat deponohen në kontejnerët komunal dhe nuk është e mundur që ato të mos grumbullohen.

Gatishmëria për të paguar për shërbimet e mbeturinave mund të përmirësohet përmes disa qasjeve duke përfshirë:

- Përmirësimin e procedurave të pagimit
- Fushatat e komunikimit të drejtuara tek përgjegjësitë e qytetarëve dhe nevojat për kryerjen e pagesave (sidomos duke theksuar faktin që tarifat do të ishin më të larta për ata që paguajnë)
- Strukturat alternative të çmimit që më shumë reflektojnë koston, p.sh. çmimet më të ulta për banesar se sa ato për shtëpitë.
- Planet alternative institucionale që dukshëm e bartin përgjegjësinë për marrjen e shërbimeve në autoritetet komunale me ndërmarrjet publike që kanë kontratën e lidhur me ta dhe që janë paguar nga buxheti komunal, të financuar nga tatimet në prone.

5.4 Mekanizmat e përkrahjes

Ndryshe nga planet e energjisë elektrike dhe siç është propozuar në këtë raport për ujin, një plan tjetër për amvisëritë e varfëra mund të jetë më pak i zbatueshëm për shkak të strukturave uniforme të çmimit aktual që janë në përdorim.

⁹ Efektet e shpenzimeve mund të ndikohen nga përfitimet e efijencës në koston e inkasimit që aktualisht është vlerësuar të jenë sa 10% i shpenzimeve të përgjithshme të shërbimeve.

Nëse qasja e tillë është marrë parasysh, atëherë implikimet e kostos për shërbimet e mbeturinave për të varfëritë 10% të popullatës do të ishin të ngjajshme me kostot e ujit, prej 1.2 EUR deri 1.5 milion në vit.

Në rekomandimet e sektorit të ujit është sugjeruar që në regjistrimin e konsumatorëve për përkrahje, përgjegjësia të jetë në konsumatorët, d.m.th. të aplikojnë në Ndërmarrjet Publike të mbeturinave për ndihmë se sa të llogarisin në bazën e të dhënave të qeverisë që mund të mos përputhet me bazën e të dhënave për konsumatorët të Ndërmarrjeve Publike.

Më mirë se sa të shkohet drejt zhvillimit të mekanizmave të ndihmës për të varfërit, rekomandohet që t'i kushtohet më shumë rëndësi ristrukturimit të planeve institucionale dhe rolit të autoriteteve komunale. Duhet t'i kushtohet rëndësi që të përdoret sistemi i tatimit në pronë si mjet kryesor të inkasimit dhe në këtë mënyrë të lehtësoj sistemin të reflektimit të kostos, sidomos për të varfërit. Brenda sistemit të tatimit në pronë është e mundur që të zhvillohen mekanizmat e përkrahjes për të varfërit përmes taksave të ulura dhe zbritjeve.